



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO TENNIS FEDERATION**

Në bazë të paragrafit 13.3 të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës të datës 24 nëntor 2018,
Bordi i Federatës miraton këtë:

RREGULLORE NR. #02

PËR

**TARIFAT PËR ANËTARËSIM NË FEDERATË
DHE PËR PJESËMARRJE NË TURNE**

VERSIONI 1.1



PËRMBAJTJA

1. Qëllimi.....	2
2. Tarifa për anëtarësi në Federatë.....	2
3. Tarifat për pjesëmarrje në turne	3
4. Dispozitat përfundimtare dhe të tjera	3

VERSIONET E DOKUMENTIT

Versioni	Në fuqi	Aprovoi / Data e aprovimit	Ndryshimet
1.0	01.01.2019	Bordi / 29.01.2019	-
1.1	01.01.2020	Bordi / 15.01.2020	2.1. Qartësohet tutje që mbikëqyrësi është përgjegjës për pagesa të anëtarësisë. 2.2.3.Referët do të paguajnë 10 EUR për anëtarësim



1. Qëllimi

- 1.1. Përmes kësaj rregulloreje caktohet tarifa e anëtarësisë në Federatë për një vit kalendarik.
- 1.2. Njëkohësisht rregullohen edhe tarifat për pjesëmarrje në turnetë e Federatës.

2. Tarifa për anëtarësi në Federatë

2.1. Anëtarësimi në Federatë vlen për një vit kalendarik. Ajo mund të paguhet përmes transferit bankar në llogarinë e Federatës, ose para pjesëmarrjes në turne me para të gatshme tek referi mbikëqyrës i turneut të parë në të cilin tenisti merr pjesë. Referi mbikëqyrës obligohet t'i dorëzojë pagesat e anëtarësisë në Federatë për të gjithë tenistët pjesëmarrës për të cilët është dashur ta mbledh anëtarësinë, në të kundërtën shuma do t'i ndalet nga mëditjet.

2.2. Tarifat vjetore në fuqi nga data 1 janar 2020 janë:

2.2.1. Klubet	50 EUR
2.2.2. Trajnerët	10 EUR
2.2.3. Referët	10 EUR
2.2.4. Tenistët (të gjitha grupmoshat)	5 EUR

2.3. Në rast se tenisti (nën 2.2.4) paguan anëtarësinë në nëntor të një viti ajo pagesë do të vlejë edhe për tërë vitin e ardhshëm, përderisa pagesa nuk është pagesë e vonuar për vitin që ikën.

2.4. Për tenistët që për herë të parë marrin pjesë në garat e Federatës, krahas pagesës duhet dërguar në email adresën e Federatës edhe kopja (e skanuar) e një dokumenti të identifikimit apo e certifikatës së lindjes.

2.5. Për asnjërën nga këto pagesa nuk lëshohet kartelë identifikimi.

2.6. Klubet, trajnerët, referët ose tenistët që nuk e paguajnë anëtarësinë, nuk mund të përfitojnë nga përkrahja e Federatës apo të jenë pjesë e aktiviteteve që organizon Federata.



3. Tarifat për pjesëmarrje në turne

3.1. Tarifat në fuqi nga data 1 janar 2020 janë:

3.1.1. Grupmoshat ROG	5 EUR
3.1.2. Grupmoshat U12-U18	10 EUR
3.1.3. Kategoria “A”	15 EUR
3.1.4. Kategoritë “35+”	20 EUR

3.2. Pagesa e tarifës do t’i sigurojë lojtarit pjesëmarrje në turne, dhe së paku ujën e pijes nga organizatori.

3.3. Tarifat paraqesin të hyra për organizatorin e turneut.

3.4. Tenisti që nuk është tërhequr nga turneu brenda afatit të caktuar dhe përfundon pjesë e shortit të publikuar, obligohet për pagesë të tarifës për pjesëmarrje.

4. Dispozitat përfundimtare dhe të tjera

4.1. Kjo rregullore hyn në fuqi nga viti kalendarik 2019 e tutje.

4.2. Hyrja e saj në fuqi shfuqizon “Rregulloren për Pagesën e Anëtarësisë për Vitin 2015” të datës 12 prill 2015, si dhe të gjitha rregulloret apo vendimet e tjera të Bordit që janë në kundërshtim me të.

4.3. Interpretimi përfundimtar i kësaj rregulloreje është kompetencë e Bordit.



Mejdi Rexhepi
Kryetar
Federata e Tenisit e Kosovës

Prishtinë, 15 janar 2020